

ANKARA (AA) - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdo?an, ka deklaruar se epoka e Turqisë që merr kredi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) është larguar prej kohësh, raporton Anadolu Agency (AA).

“Turqia e mbylli kapitullin e FMN-së në maj të vitit 2013 dhe me dëshirën e Zotit, ai nuk do të rihapet”, tha Erdo?an para grupit parlamentar të partisë së tij për Drejtësi dhe Zhvillim (AK Parti).

Erdo?an kritikoi pretendimet e partisë opozitare Republikane Popullore (CHP) se Turqia do të kërkojë të negociojë me FMN-në pas zgjedhjeve vendore të caktuara më 31 mars.

“Është e qartë se kush ka shkuar në FMN. Ata që kanë mentalitetin e CHP-së, ata kanë shkuar në FMN”, tha Erdo?an.

Rreth gjashtë vjet më parë, Turqia pagoi gjithë borxhin e saj tek institucioni ndërkombëtar i huadhënies.

Erdo?an po ashtu tha se aksionet e CHP-së në huamarrësin privat të Turqisë Isbank do të transferohen në Thesarin e shtetit, duke theksuar se “Ky parlament do ta marrë atë vendim së shpejti”.

Pas vdekjes së Mustafa Kemal Atatürkut në vitin 1938, themeluesit të Republikës turke, 28,1 për qind e aksioneve të tij në Isbank iu transferuan CHP-së.

CHP-ja nuk merr asnjë pjesë të fitimeve nga Isbank, por ka katër vende në bordin e saj administrativ.